

VENDIM
Nr.412, datë 22.4.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.1392, DATË 17.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR VIRUA- GJIROKASTËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.1392, datë 17.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

i) Sipërfaqes së tokës truall 3 827 m² i shtohen edhe 460 m².
ii) Vlerës së tokës truall nga 70 642 101 (shtatëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e njëqind e një) lekë, i shtohen edhe 10 423 140 (dhjetë milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e njëqind e dyzet) lekë;

iii) Vlerës së objekteve 17 977 763 (shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë i shtohen edhe 2 011 075 (dy milionë e njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

iv) Vlerës së përgjithshme të shpronësimit 88 867 619 (tetëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë i shtohen edhe 12 434 215 (dymbëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 12 434 215 (dymbëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

5. Pronarët e shënuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët bëhet shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Për objektet, pronarët, përveç dokumentacionit të pronësisë, duhet të paraqesin dhe dokumentacionin tekniko-ligjor.

6. Shpronësimi shtesë të fillojë më 30 prill 2009 dhe të përfundojë më 30 korrik 2009.

7. Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi proces gjyqësor, do të kompensohet, për efekt shpronësimi, pronari, që do të rezultojë si i tillë me vendim të formës së prerë të gjykatës.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 5 të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

